

INTERNATIONAL CRIMINAL TRIBUNAL FOR THE PROSECUTION  
OF PERSONS RESPONSIBLE FOR SERIOUS VIOLATIONS  
OF INTERNATIONAL LAW COMMITTED IN THE TERRITORY  
OF THE FORMER YUGOSLAVIA SINCE 1991



**PLOTËSIM**

**i deklaratës së dhënë nga Ruzhdi KARPUZI,  
ERN: U003-4892-U003-4901**

1. Quhem Ruzhdi KARPUZI, u lindi më 23 janar 1965 në Shalë të komunës së Lipjanit në Kosovë. Më 19 dhe 21 korrik 2003, më intervistoi hetuesi Ole LEHTINEN dhe një ditë më vonë, pasi deklarati mu lexua nga përkthyesi Durim BANI, e nënshkruajta.
2. Sot, më 6 shkurt 2005, jam takuar me hetuesin Ole LEHTINEN dhe Juristin Julian NIÇOLLS në TPNJ në Hagë për t'u përgatitur për dëshminë time në gjyq. Më është dhënë përkthimi i deklaratës sime të mëparshme në gjuhën shqipe dhe e kam lexuar me kujdes. Pas leximit të deklaratës, përfaqësuesve të zyrës së prokurorisë u kam bërë korrigjimet në vijim:
3. Në fund të paragrafit 6 kam përshkruar se fshatarët kanë ardhur të na ndihmojnë gjatë betejës. Në deklaratë është shënuar se këta fshatarë nuk kanë pasur armë. Dua ta korrigjoj këtë në atë kuptim se unë kam deklaruar se disa kanë pasur armë e disa nuk kanë pasur. Është e saktë se disa prej tyre kanë pasur vetëm sopata dhe mjete të tjera. E di se këtë e kam deklaruar qysh në kohën e intervistës dhe nuk e di se si ka ndodhur gabimi.
4. Në paragrafin numër 7 ka një gabim në përkthimin shqip të cilin e lexova. Aty thuhet se **kam** ditur për Shtabin mbi Llapushnik. Unë kam deklaruar se **nuk** kam ditur për asnjë Komandë mbi Llapushnik dhe sipas hetuesit Ole Lehtinen ashtu thuhet në versionin anglisht të deklaratës sime të nënshkruar.
5. Në paragrafin 8, shtëpia e Gëzim GASHIT është përmendur si "pika jonë kryesore" për një kohë të caktuar gjatë verës së vitit 1998. Dua ta qartësoj këtë. Ajo që unë kam menduar është se ka qenë pikë kryesore për mua dhe ushtarë të tjerë dhe nuk kam dashur të them se ka qenë pikë kryesore e UÇK në Llapushnik.
6. Në paragrafin numër 14, e kam përshkruar se çka ka ndodhur pasi që jam plagosur më 26 korrik 1998. Dua të them se nuk mund të jem i specifik për rrugën që e kemi bërë me traktor atë ditë. Kur kam menduar për këtë gjë pas intervistës, më është kujtuar se shokët të cilët më kanë ndihmuar, më kanë thënë se kemi kaluar përmes Orllatit dhe Tërpezës,

Signature \_\_\_\_\_

(Witness)

Initials \_\_\_\_\_

(Others present)

por nuk më kujtohet se si kemi arritur deri në Kleçkë. Kam qenë në gjendje të keqe dhe për atë arsye nuk mund të jem preciz për këtë.

7. Në paragrafin numër 15 shkruan se kur u ktheva në fshatin tim u bëra udhëheqë skuadre. Më kujtohet se këtë term e kemi diskutuar me hetuesin edhe gjatë bisedës në intervistën e parë. Pozitën time do ta përshkruaja si udhëheqës të grupit të shokëve në fshat.
8. Përveç korrigjimeve të bëra në këtë deklaratë, deklarata e dhënë në korrik të vitit 2003 është e saktë.
9. Krahas kësaj, më është treguar fotografi e Llapushnikut e marrë nga lartë. Fotografia është e shënuar me numrin e provës U008-3708. Në këtë fotografi mund ta shënoj pozitën luftarake në të cilën ndodhesha gjatë betejës së fundit më 26 korrik 1998.
10. Gjithashtu më është treguar një kopje e një ditar shënimesh, e shënuar me numrin e provës U002-3460-U002-3492. Nuk e njoh këtë ditar që më është treguar sot, por i përngjan llojit të ditarit të shënimeve e cila mbahej në pozicionet për të shënuar vëzhgimet në terren.

Signature \_\_\_\_\_  
(Witness)

Initials \_\_\_\_\_  
(Others present)

**WITNESS ACKNOWLEDGEMENT**

*This Statement has been read over to me in the Albanian language and it contains everything I said, to the best of my knowledge and recollection. I have given this Statement voluntarily and am aware that it may be used in legal proceedings before the International Criminal Tribunal for the Prosecution of Persons Responsible for Serious Violations of International Law Committed in the Territory of the Former Yugoslavia since 1991.*

Signed: \_\_\_\_\_  
(Witness)

---

---

**INTERPRETER CERTIFICATION**

*I, Ariana KICA, Interpreter, certify that:*

- 1. I am duly qualified and approved by The Registry of the International Criminal Tribunal for the Prosecution of Persons Responsible for Serious Violations of International Law Committed in the Territory of the Former Yugoslavia since 1991 to interpret from the Albanian language into the English language and from the English language into the Albanian language.*
- 2. I have been informed by Mr Ruzhdi KARPURI that he speaks and understands the Albanian language.*
- 3. I have orally translated the above statement from the English language to the Albanian language in the presence of Mr KARPURI, who appeared to have heard and understood my translation of this Statement.*
- 4. Ruzhdi KARPURI, has acknowledged that the facts and matters set out in his Statement, as translated by me, are true to the best of his knowledge and recollection and has accordingly signed his signature where indicated.*

Signed and dated: \_\_\_\_\_  
(Interpreter)

Signature \_\_\_\_\_  
(Witness)

Initials \_\_\_\_\_  
(Others present)